

DEFTERËT OSMANË TË REGJISTRIMIT TË POPULLSISË

Mungesa e burimeve të vjetra të shkruara para Buzukut e Matrëngës është ndier nga të gjithë ata studiues, që janë marrë me periudhat e hershme të historisë së Shqipërisë dhe të gjuhës shqipe. Për të plotësuar këtë mungesë, ata kanë shfrytëzuar me dobi burime të tjera, sidomos të dhënat e zbulimeve arkeologjike, informatat nga autorët e vjetër grekë, romakë etj. si edhe huazimet e shqipes nga gjuhët e tjera, sidomos nga gjuhë të tilla si greqishtja e vjetër, latinishtja, gjuhët sllave të Ballkanit etj. Por kohët e fundit ka nisur të shfrytëzohet me dobi edhe një tjetër burim i rëndësishëm si nga historianët, ashtu edhe nga gjuhëtarët dhe pikërisht Defterët e vjetër Osmanë për regjistrimin e popullsisë që, fatmirësisht, janë ruajtur në Arkivat e Stambollit. Siç dihet, në ata defterë janë regjistruar emrat e kryefamiljarëve të qyteteve dhe të fshatrave të vendeve të pushtuara nga ushtritë turke për të marrë prej tyre detyrimet, kryesisht në prodhime bujqësore e blegtorale a në të holla. Në regjistrat osmanë, siç dihet, zakonisht janë shënuar emrat e kryefamiljarëve (ose beqarëve) meshkuj e, aty-këtu, edhe femra, kur këto ishin gra të veja. Gjithsesi, nga emrat e kryefamiljarëve mund të kuptohet pa vështirësi edhe përkatësia etnike e gjithë familjeve, që ata përfaqësonin.

Në vështrim të parë, mund të duket se në këtë rast nuk ka ndonjë gjë të rëndësishme për të vënë në dukje. Por, po të shqyrtohen me kujdes të dhënat, që mund të nxirren sidomos nga defterët më të vjetër osmanë, atëherë del e qartë se ato hedhin dritë mbi shumë çështje, që kanë të bëjnë me periudhën e Mesjetës së vonë dhe të hershme të historisë së popullit shqiptar dhe të gjuhës shqipe. Megjithëse regjistruerit osmanë, për shkak të ndryshimeve të mëdha midis turqishtes dhe gjuhës shqipe dhe

për shkak të përdorimit të alfabetit arab, që nuk i ka të gjitha shkronjat e nevojshme të sistemit fonetik të shqipes, e kanë pasur të vështirë t'i shënonin me saktësi emrat e banorëve shqipfolës, prapë ata kanë arritur të na japin informata të mira rreth gjendjes demografike të viseve të banuara nga shqiptarët në periudhat, kur janë bërë regjistrimet e popullsisë. E, nëpërmjet atyre të dhënave, që pasqyrojnë gjendjen demografike të shekujve XV-XVII, e cila është rezultat i zhvillimeve të përfutuara gjatë shekujve të mëparshëm, mund të nxirren përfundime të sigurta për gjendjen demografike të viseve të banuara nga shqipfolësit edhe për mjaft shekuj më parë. Gjithashtu, duke krahasuar gjendjen demografike të viseve shqiptare të pasquara në deferët osmanë me gjendjen e sotme demografike të këtyre viseve, mund të nxirren përfundime të sigurta edhe për ndryshimet e vërtetuara në këto vise gjatë periudhës së sundimit osman.

Por, që të mos mbetemi në fushën e teorizimeve të përgjithshme, le t'i ilustrojmë këto mendime me disa të dhëna konkrete. Natyrisht, shqyrtimi i këtij problemi me hollësi në të gjitha fushat do të kërkonte një trajtim të gjerë, që i kapërcen caqet e një artikulli. Prandaj në këtë artikull do të ndalemi kryesisht në të dhënat, që mund të nxirren nga defterët osmanë më të hershëm për përbërjen etnike të viseve shqiptare e sidomos të atyre viseve, që, duke u mbështetur në gjendjen e sotme, duket sikur paraqisin probleme të papritura. Pra, në këtë artikull do të përqëndrohemi në sqarimin e këtyre dy pyetjeve: 1. Si paraqitet gjendja etnike e trojeve të sotme shqipfolëse në kohën e regjistrimeve më të vjetra osmane dhe si ishte përfutur ajo gjendje etnike? 2. Si ka qenë gjendja etnike para pushtimit osman në ato zona dikur shqipfolëse, ku sot flitet greqisht? Por, para se të merremi me sqarimin e këtyre dy pyetjeve, është e nevojshme të vihen në dukje disa ngjarje të rëndësishme të mëparshme, që mund të kenë ndikuar për mirë a për keq në krijimin e gjendjes demografike në kohën e regjistrimeve osmane.

Siç dihet, pas pushtimeve turke një pjesë e popullsisë shqiptare nga Veriu dhe nga Jugu u detyrua të mërgonte në Itali. Gjithashtu, gjatë shekullit XIV, si edhe më parë e më pas, një numër i konsiderueshëm banorësh shqiptarë, sidomos nga viset jugore, mërguan në treva të ndryshme të Greqisë. Të kihet

parasysh, gjithashtu, se gjatë shekujve X-XIV trojet shqiptare u pushtuan më parë nga mbretëria bullgare dhe më pas nga mbretëria serbe. Veç kësaj, do pasur parasysh se kisha ortodokse shqiptare ishte nën ndikimin e kishës greke. I përmenda shkurt këto ngjarje kryesore, për të vënë në dukje se rrethanat historike-shoqërore para kohës së regjistrimeve osmane nuk mund të ndikonin për përhapjen e elementit shqipfolës, por përkundrazi duhet ta kenë rrudhur sadopak atë. Edhe pas pushtimit turk, në kohën e regjistrimeve të para osmane, kur nuk kishte nisur ende procesi i islamizimit të një pjese të popullsisë, për turqit të gjithë ishin të detyruar t'i paguanin njësoj detyrimet ndaj pushtuesit. Prandaj regjistruesisit i shënonin emrat e tyre pa asnjë dallim. E tashti le të kthehemi në sqarimin e dy pyetjeve të mësipërme.

Nga shqyrtimi i defterëve më të vjetër osmanë, që janë deshifruar deri sot nga studiuesi turk Halil Inancik dhe nga studiuesit shqiptarë Vexhi Buharaja, Selami Pulaha, Ferit Duka, David Luka, Petrika Thëngjilli etj., del se kryefamiljarët e familjeve të regjistruara në viset shqipfolëse të asaj kohe mbartnin në përgjithësi emra karakteristikë shqiptarë, si: Lekë, Gjon, Gjo-kë < Gjon-kë, Gjin, Gjikë < Gjin-kë, Gjergj, Pal, Martin etj. Në viset jugore ndeshen edhe trajta të disave prej këtyre emrave të ndikuara nga grekët, si: Aleksandër, Jani, Jorgo a Jorgji, Pavllo etj. Siç shihet, emrat e tipit Lekë, Gjon, Gjin etj., në krahasim me trajtat burimore, në gojën e të parëve të shqiptarëve kanë pësuar ndryshime të mëdha fonetike. Kështu p.sh., emri Lekë, në krahasim me trajtën burimore epiroto-maqedonase Aleksandros, ka pësuar ndryshime të tilla fonetike që për lexuesin e thjeshtë duken si të pamundura. Por do pasur parasysh se gjuha shqipe ka bërë ndryshime të mëdha fonetike në fjalët e vjetra, sidomos në emrat e përveçëm. Të kihet parasysh, p.sh., se emri i Berat-it e ka burimin tek emri Belgrad, me të cilin bullgarët gjatë pushtimit të Shqipërisë (shekujt X-XIII) e ndryshuan emrin e mëparshëm të këtij qyteti të vjetër. Dhe është një gjë e ditur që sllavët në përgjithësi në vendet e pushtuara e kishin zakon t'i sllavizonin emrat e shumë vendeve. Mjafton të përmendim, sa për shembull, rastin e emrit të Raguzës, një ish-koloni e grekëve të vjetër, së cilës sllavët ia ndryshuan emrin në Dubrovnik. Prandaj shndërrimi i emrit Aleksandros në Lekë me rënien e tingullit nistor dhe të

disa tingujve të tjerë në fund, nuk është i papritur në gojën e shqiptarëve gjatë shekujve të mëparshëm. Për më tepër, emri Lekë duhet të jetë një ndër emrat më të vjetër ndër shqiptarët, për çka dëshmon prania e tij si ndër shqiptarët e Veriut, ashtu edhe ndër ata të Jugut. Mjafton të përmendim këtu emrat e Lekë Dukagjinit dhe të Gjolekës < Gjon Leka.

Ndryshime të mëdha fonetike kanë pësuar edhe mjaft emra të tjerë personash, si p.sh., emri Gjon, i cili e ka burimin te latinishtja Jo<nnes dhe kjo nga hebraishtja Jochanan. Emri Gjon është një ndër emrat më të vjetër në përdorim nga stërgjyshërit tanë e këtë e dëshmon jo vetëm karakteri i tij mbarëshqiptar, por edhe ndryshimet e mëdha, që ky emër ka pësuar në krahasim me trajtën latine Jo<nnes, e cila, në gojën e stërgjyshërve tanë, ka pësuar disa ndryshime të vjetra fonetike, si kalimi i theksit mbi rrokjen e parë, karakteristikë kjo e fjalëve të vjetra të shqipes, evolucioni i tingullit nistor /J-/ në /Gj-/ ashtu si te gjymtyrë < latinisht iunctāra etj., si edhe rënia e tingujve të patheksuar pas rrokjes së parë. Këto ndryshime bien edhe më tepër në sy, po të krahasohet trajta shqiptare Gjon me trajtën greke Jani-s, me italishten Giovanni, me frëngjishten Jean (= Xh>), me serbishten Jovan, me rusishten Ivan etj. Emri Gjon del edhe i zgjeruar me prapashtesën -kë: Gjokë < Gjon-kë.

Për sa i takon emrit Gjini, ky, në përgjithësi, mbahet si një variant shqiptar i emrit Gjon e për këtë do të dëshmonte edhe emri i skelës së Shën Gjinit, që italianët e kanë përkthyer San Giovanni di Medua. Gjithsesi, Gjini është një emër karakteristik shqiptar, që nuk ndeshet tek asnjë popull tjetër ballkanik. Ndër shqiptarët ai ndeshet edhe në trajtën Gjikë < Gjini-kë, d.m..th. i zgjeruar me prapashtesën -kë, ashtu si Gjo-kë < Gjon-kë.

Vlen të shënohet se emrat Lekë, Gjon e Gjini si edhe Gjokë e Gjikë dëshmohen, ku më shumë e ku më pak, në të gjitha trevat, ku flitet shqip. Mjafton të përmendim, sa për shembull, Gjon Kastriotin, Gjon Buzukun, Gjon Zenebishin, Gjon Muzakën, Gjini Bua Shpatën, Gjini Muzakën, krahinën e Dukagjinit < Duka Gjini, Lekë Dukagjini, Gjoleka < Gjon Leka etj. Në këtë artikull do të japim shembuj vetëm nga ato treva, ku sot flitet greqisht, por ku dikur, sipas dëshmive të deferëve osmanë, gjuha amtare mbizotëruese ka qenë shqipja. Për këtë arsye dhe në përputhje

me synimet e këtij artikulli, në paragrafët ndjekës do të japim shembuj nga defterët osmanë për vilajetin e Janinës, për luginën e Dropullit dhe Vurgun e Delvinës, d.m.th. për ato treva, ku gjuha shqipe është mënjanuar nga greqishtja. E, për të mos u zgjatur pa nevojë, po përmend këtu vetëm disa raste nga regjistrimet e vjetra osmane në viset jugore, si ato që ka përmendur Ferit Duka në disa artikuj të tij të botuar në revistën shkencore “Studime historike”, si edhe disa nga të dhënat e defterit osman të Janinës të vitit 1581-62, që është transkribuar nga Vexhi Buharaja dhe që gjendet dorëshkrim në Arkivin e Institutit të Historisë, këtu në Tiranë.

Siç do të vihet në dukje më poshtë, në regjistrimet osmane të shekujve të parë të pushtimit të të ashtuquajturit Epir mbizotërojnë emra tipikë shqiptarë, megjithëse nën ndikimin e kishës ortodokse nuk mungojnë edhe trajta emrash të tipit grek, gjë që është e kuptueshme për një zonë të tillë kufitare me grekët, siç ishte Epiri. Shqyrtimi i të gjithë onomastikës së pasqyruar në regjistrat osmanë për këtë zonë do të kërkonte shumë hapësirë. Por një punë e tillë do të meritonte më shumë vëmendje se deri sot, për të parë ndryshimet e vërtetuara sidomos në onomastikën e popullsisë së viseve dikur shqipfolëse, që pas vitit 1912 mbetën brenda kufijve të shtetit grek. Kështu p.sh., në vendin tonë nuk janë botuar ende të dhënat onomastike të defterëve osmanë të shekujve të parë pas pushtimit turk të vendbanimeve, të tilla si: Arta a Narta, Preveza, Janina etj. Por, sipas një kumtimi miqësor të historianit Ferit Duka, së shpejti do të botohet në revistën “Studime historike” 1-2/ 2007 një studim i tij për kazatë çame të Ajdonatit (Paramithisë) dhe të Mazrakut, me të dhëna edhe për onomastikën e atyre kazave sipas defterëve osmanë të vjetëve 1551 dhe 1583. Ai pati mirësinë të më jepte një kopje të atij studimi. Pastaj do të përmend disa të dhëna onomastike të defterëve osmanë të shekujve të parë të pushtimit turk për disa vise të Epirit, që kanë mbetur brenda kufijve të shtetit grek, ashtu si na paraqiten në defterët osmanë të vjetëve 1581-82, që janë transkribuar nga Vexhi Buharaja dhe gjenden në Arkivin e Institutit të Historisë në Tiranë. Dhe, më pas, do të përmend disa të dhëna të defterëve osmanë për luginën e Dropullit dhe për Vurgun e Delvinës, ku sot flitet greqisht, si edhe për disa

fshatra të Bregdetit Jugor (Himara, Dhërmiu dhe Palasa), ku gjatë shekujve të fundit, krahas shqipes është përhapur edhe greqishtja, sidomos midis meshkujve. Por edhe për këto zona do të merren në shqyrtim vetëm disa emra karakteristikë shqiptarë, si Lekë, Gjon e Gjin, që, siç u vu në dukje pak më sipër, për nga evolucioni fonetik kanë pësuar ndryshime të mëdha në përjasje me trajtat burimore si edhe me trajtat gjegjëse të gjuhëve të tjera.

Dhe po e nisim me Ajdonatin (Paramithinë) dhe Mazrakun, treva të Çamërisë, që sot bëjnë pjesë në shtetin grek dhe prej nga popullsia e mëparshme (muslimane) shqipfolëse është detyruar të shpërngulet për në Turqi, sidomos pas Luftës I Botërore, duke u cilësuar si turq, ose për në Shqipëri, pas Luftës II Botërore (shih B. Meta, 2002, 160vv.). Ajdonati, qendër qytetare, sipas regjistrimit osman të vitit 1583, kishte rreth 600 shtëpi, d.m.th. kishte një popullsi prej rreth 4.500-5.000 frymësh (shih Duka 2007/f. 3). Ndër emrat e shumtë të kryefamiljarëve të këtij vendbanimi atëherë, bien në sy edhe disa emra tipikë, që ndeshen në të gjitha trevat shqipfolëse të asaj kohe. Këtu do të ndalemi kryesisht në emrat Lekë, Gjon, Gjin, që paraqesin më shumë interes, sepse dalin me forma, që nuk ndeshen në gjuhë të tjera, ballkanike ose joballkanike, pra dëshmojnë se i janë nënshtruar prej kohësh të hershme një evolucioni të pandërprerë në gojën e shqipfolësve gjatë shekujve.

Kështu, në defterin e shekullit XVI, për Ajdonatin dhe Mazrakun gjejmë, ndër të tjerë: Mensh Leka (beqar), Dhimo Leka dhe Pal Leka nga Dragani, Leka Duka nga Gllavica, Nika Leka, Leka Çero, Leka Vlashi, Leka Llazari, Deda Llaq Leka, Leka Meçari, Nika Leka (2 herë), Leka Llaqi, Jani Leka, Janji Leka, Ilia Leka, Reç Leka, Kalir(?) Leka, Asti Leka, Leka Kondi, Leka Gjini, Leka Deda, Leka Nika, Gjin Leka, Leka Gjini, Gjon Leka, Jorgo Leka, Leka Jani, Thanas Leka, Andria Leka, Leka Mosira, si edhe Hasan Leka e Ahmed Leka.

Emri Lekë ndeshet, megjithëse më pak, edhe në defterin osman të vitit 1582-83 për vilajetin e Janinës. Kështu p.sh., për vetë qytetin e Janinës në atë regjistër gjejmë: Lekë Dhijaku. Por disi më dendur ai ndeshet nëpër fshatrat e atij vilajeti, si p.sh., në fshatin Vishtavec i Madh gjejmë: Lekë Kordili, Lekë Goride,

Lekë Golari. Po në këtë fshat, është regjistruar edhe Jani Lakra. Kurse për qytetin e Prevezës, që sipas atij defteri paraqitet me rreth 70 banorë, sepse, me sa duket, në atë kohë popullsia nga ai vendbanim do të kenë qenë larguar, emri Lekë del vetëm një herë: Lekë Kuqino, si edhe Jorgji Leka.

Sipas defterëve osmanë të shekullit XVI (shih F. Duka: Studime historike 1-2/2007), në Ajdonat edhe emri Gjon ndeshet mjaft dendur jo vetëm si emër personi, por edhe si llogar. Për të mos e rënduar pa nevojë punimin, po rendisim këtu vetëm disa shembuj nga fshatrat Karbunarë dhe Kurtes. Nga fshati Karbunarë, në regjistrimin e vitit 1551: Gjon Llaqi, Gjon Tupe, Gjon Nika (2 herë), Gjon Koleci, Gjon Çero, Pal Gjoni, Gjin Gjoni, Nika Gjoni, Gjon Kondi etj. Po kështu, në fshatin Kurtes: Gjon Bustra, Pollo ((Bulo?) Gjoni, Sino Gjoni, Andria Gjon-dhima, Nika Gjoni, Pal Gjoni, Gjon Reçi, Gjon Dhimo, Deda Gjoni, Nika Deda-gjoni, Gjon Dade (Daka?), Stamad Gjoni, Ahmed Gjoni. Po kështu, në regjistrimin e vitit 1583: Pal Gjoni, Gjin Gjoni (2 herë), Gjon Nika (2 herë), Dhimo Gjoni, Kushe Gjoni, Gjon Pone, Gjon Pali, Nika Gjoni, Gjon Kondi, Gjon Mamazhupa, Duka Gjoni, Gjon Lala, Llaq Gjoni (shih Duka: 2007, f. 10 - 14).

Emri Gjon del dendur edhe në fshatin Kurtes të Mazrakut. Kështu, në regjistrimin e vitit 1551: Dhima Gjoni, Andria Gjoni (3 herë), Kosta Gjoni, Gjon Jani (2 herë), Menksh Gjoni, Gjon Menkshi, Pal Gjoni (2 herë), Gjon Deda (2 herë), Gjon Nini, Leka Gjoni, Tupe Gjoni, Gjon Tupe, Gjon Leka, Gjin Gjoni, Nika Gjoni. Edhe në regjistrimin e vitit 1583, emri Gjon në këtë fshat del dendur: Andria Gjon-dhima, Pollo (Bulo?) Gjoni, Gjurko Gjoni, Gjon Bustra, Jorgo Gjoni, Nika Gjoni (2 herë), Sino Gjoni, Pal Gjoni, Ahmed Gjoni, Gjon Reçi, Gjon Dhimo, Deda Gjoni (2 herë), Gjon Pollo (Bulo?), Mehmed Gjon-sino, Stamad Gjoni (shih Duka: 2007, 14-15).

Në viset më jugore të Epirit, sipas defterëve osmanë të vitit 1582-83, emri Gjon shfaqet gjithnjë e më rrallë, sepse është zëvendësuar gjithnjë e më shumë nga trajta e ndikuar prej greqishtes Jani. Kështu p.sh., në qytetin e Janinës, emri Gjon del vetëm nja katër herë, si: Gjon Laskari, Gjoni Halika, Niko Gjon-çi, Dimo Gjoni, ndërsa nëpër fshatrat e Janinës del disi më dendur, por jo edhe aq shumë.

Për qytetin e Prevezës me shumë pak banorë në atë kohë, sipas atij defteri Gjon nuk del fare. Por del në fshatin Koka – Kandan: Atanas Gjoni, Apostoli Gjoni. Po kështu, në fshatin Pigodolje: Todor Gjoni etj. Edhe më rrallë del emri Gjon në qytetin e Artës a Nartës, ku gjejmë: Gjon Tabani.

Emri Gjin del shumë dendur në defterët osmanë të shekullit XVI për Ajdonautin dhe Mazrakun, siç dëshmojnë materialet e botuara nga F. Duka (1-2/2007, f. 11-16): Gjin Jorga, Gjin Gjoni, Gjin Kemexhiu, Gjin (I)Steri nga Gjuri, Gjin Nikolla, Gjin Moçare, Gjin Gjurka, Gjin Nika, Gjin Mirali, Gjin-aq Tupe, Gjin Todri, Tupe Gjin Todri, Gjin Ngjevi, Ngjevi Gjini, Deda Gjini, Nika Gjini, Martin Gjini, Gjin-lala Marushi, Martin Gjin Lala, Llaq Gjini, Niko Gjini, Gjin Lapa, Gjin Dhimaqi, Gjin Jani, Dhimo Gjini, Nika Gjini, Thanas Gjini, Gjin Andria, Ahmed Gjini, Hasan Gjini, Osman Gjin-leka.

Por, sipas defterit osman të vitit 1582-83, në viset më jugore të Epirit, emri Gjin, ashtu si emri Gjon, del më rrallë, megjithëse diçka më shumë se emri Gjon, sidomos nëpër fshatra. Kështu, në atë defter për qytetin e Janinës emri Gjin del rreth katër herë, si: Lagja Alqije Gjini, Gjin Rijosomat, Gjini Halika, Gjin Iskobri. Por nëpër fshatra del disi më dendur. Kështu p.sh., në fshatin Sadovica del tri herë: Jorgo Gjini, Paskal Gjini, Todor Gjini. Po kështu, në fshatin Servjanie del pesë herë: Gjin Dimo (2 herë), Gjin Colje, Gjin Jorgo, Komnen Gjini.

Edhe në qytetin e Prevezës, sipas atij defteri, edhe emri Gjin del në dy raste: Gjin Marko, Lekë Kuqino, Gjini i biri.

Pak a shumë e njëjtë paraqitet gjendja për emrin Gjin edhe në zonën e Nartës, si p.sh., në qytetin e Nartës: Gjin Mutafi (2 herë), Dimo Gjini, Gjin Ishtamadi.

Do pasur parasysh se emri Gjin, ashtu si emri Gjon, del edhe i zgjeruar me prapashtesën -kë: Gjikä < Gjin-kë. Edhe kjo trajtë e zgjeruar dëshmohet qysh herët si në trevat shqipfolëse veriore, ashtu edhe në ato jugore. Por, ndërsa trajta Gjo-kë < Gjon-kë ndeshet më fort në të folmet veriore, trajta Gjikä është përhapur kryesisht në të folmet jugore, sidomos në ato të Labërisë, ku ndeshet edhe si emër familjeje a fisi jo vetëm ndër të krishterë, por edhe ndër muslimanë, si p.sh., në rrethin e Vlorës. Por trajta e zgjeruar Gjikä, ashtu si Gjokë, nuk del në materialet e

botuara nga F. Duka (1-2/2007) për viset çame të Ajdonatit dhe Mazrakut gjatë shekullit XVI. Vetëm në një rast ndeshet emri Llaq Gjink-o (f.14) në fshatin Kurtës. Pak a shumë e njëjtë paraqitet gjendja edhe për vilajetin e Janinës, por, sipas defterit osman të lartpërmendur, emri Gjikë ndeshet edhe në lagjen Hamam të Janinës: Gjikë Mutafi.

Prania gjithnjë më e paktë e emrave Gjon, Gjin e Gjikë në viset më jugore të Epirit është pasojë e përhapjes së trajtës së ndikuar nga greqishtja Jani në ato vise. E ky ndikim i kishës greke bëhet gjithnjë e më i madh sa më shumë shkohet drejt jugut. Nuk mungojnë edhe raste të pranisë së trajtave Gjin e Gjon dhe Jani tek i njëjti person, natyrisht si emër e mbiemër, si p.sh., Jani Gjini në qytetin e Janinës.

Por, përveç emrave tipikë shqiptarë, si ata që u përmendën këtu më sipër, prania e elementit shqipfolës në viset më jugore të Epirit dëshmohet edhe nëpërmjet emrash të tjerë, që kanë në përbërjen e tyre disa tinguj bashkëtingëllorë, që i mungonin greqishtes së periudhës kur është bërë regjistrimi osman. Është fjala për emrat, që përmbajnë zanoren /ë/ si edhe tingujt bashkëtingëllorë /b/, /d/, /g/, /c/, /x/, /ç/, /x/h/, që i mungojnë greqishtes së re. Madje, katër bashkëtingëlloret e fundit i mungonin edhe greqishtes së vjetër, prandaj edhe në alfabetin grek mungojnë shkronjat përkatëse për këta tinguj. Prandaj grekët, fjalët prej burimi jogrek, që përmbajnë këta tinguj, i pasqyrojnë me anë dyshkronjësash, ashtu siç veprojnë edhe për bashkëtingëlloret /b/, /d/¹, sepse shkronjat përkatëse të këtyre bashkëtingëlloreve të fundit në greqishte e kanë ndryshuar shqiptimin prej kohësh, duke marrë vlerën e bashkëtingëlloreve fërkimore /v/, /dh/². Nga ana tjetër, edhe regjistruesisit osmanë, që, siç dihet, kanë përdorur alfabetin arab, kanë pasur vështirësi për të pasqyruar tingujt bashkëtingëllorë /c/, /ç/, /zh/, /p/ dhe /ll/. Ata janë përpjekur t'i pasqyrojnë në njëfarë mënyre edhe këta tinguj, natyrisht jo gjithnjë me sukses. Gjithsesi, ata emra banorësh, që në defterët osmanë kanë në përbërjen e tyre bashkëtingëlloret /b, c, ç, d, xh/, përfaqësojnë banorë jogrekë. Të tillë janë, ndër të tjerë: Baboçi, që del shpesh në defterët osmanë të vitit 1582-83, si p.sh.: Todor Baboçi, Dimo Baboçi, Jani Baboçi, Thoma Baboçi, Shimi Baboçi, Lekë Baboçi, Nikolla Baboçi në lagje

të ndryshme të qytetit të Nartës, ku janë regjistruar edhe Jani Bashmakçiu, Jani Begadje, Nikolla Banja, Nikolla Bakalli, Niko Lumbarda, Jani Brankandi, Todor Pobroni, Miho Samarxhiu e të tjerë, që përmbajnë tinguj të pazakontë për greqishten e asaj periudhe. Emra me një përbërje të tillë tingullore dëshmohen në këtë regjistër edhe për vise të tjera të vilajetit të Janinës, por këtu përmendëm disa emra nga qyteti i Nartës, i cili përfaqëson vendbanimin më jugor të Epirit. Për më tepër, ky vendbanim paraqet interes edhe për vetë emrin dhe historinë e tij.

Në përgjithësi, mendohet se Arta, ish-Ambrakia, ishte një koloni e themeluar nga korinthisit rreth vitit 657 para erës së re. Dhe, siç dihet, grekët e vjetër themelonin “koloni” tregtare në vende të banuara nga popullsi jogreke³. Emri Arta a Artë prej kohësh del në trajtën Nartë, ku elementi i parë burimisht ka qenë një parafjalë, që kishte në përbërjen e saj tingullin /n-/. Pas gjithë gjasash, ky tingull lidhet me parafjalën shqipe në, pra Nartë ka dalë nga togu (Po shkoj) në Artë. Ka më pak gjasë që në këtë rast tingulli protetik /n-/ të lidhet me parafjalën greke en “në”, po të kihet parasysh se në një rast të ngjashëm grekët kanë përdorur parafjalën eis (= is) “në, drejt”, siç del nga emri i (I)stambulit, që ka dalë nga evolucioni i togfjalëshit eis tēn polin [= is tin polin) “(po shkoj) në qytet a drejt qytetit”). Një dukuri e ngjashme ka ndodhur edhe me fshatin e Nartës pranë Vlorës, që banohet nga një popullsi greqishtfolëse, e sjellë, me sa duket, nga popullsia greqishtfolëse në zonën e Artës a Nartës së Greqisë në një të kaluar jo edhe aq shumë të largët, ashtu si në fshatrat e Dropullit e të Vurgut (shih për këto pak më poshtë).

Nga sa u parashtrua shkurt këtu më sipër, del e qartë se në shekullin XVI, d.m.th. pas pushtimit turk, banorët e Ajdonatit e të Mazrakut. mbanin në përgjithësi emra shqiptarë, pra i përkisnin etnosit shqiptar. Por, natyrisht, për atë zonë atëherë është vështirë të mendohet një popullsi krejt homogjene, e papërzier me elemente greqishtfolëse. E njëjta gjë duhet menduar për atë periudhë edhe për shumicën e viseve të Epirit më në jug të trevave të lartpërmendura. Është fjala për viset e vilajetit të Janinës, duke përfshirë këtu edhe Prevezën e Nartën, por në ato vise ndikimi grek ka qenë edhe më i fuqishëm e kjo duket qartë nga mbizotërimi i trajtave të emrave të ndikuar nga greqishtja

Jani, Jorgo, Pavllo, Petro etj.. Gjithsesi, do mbajtur parasysht se gjatë shekujve pasardhës greqishtja ka ardhur duke u përhapur dalngadalë në viset kufitare jogreke falë disa faktorëve, që u vunë në dukje edhe gjatë këtij artikulli. E ky proces mori përmasa më të mëdha sidomos pas shpalljes së pavarësisë së shtetit grek më 1821, kur administrata dhe Kisha Ortodokse Greke filluan një fushatë sistematike për këtë qëllim, duke i mëshuar gjithnjë e më shumë faktorit fetar në vend të faktorit etnik, d.m.th. duke e barazuar ortodoksizmin me kombësinë greke. Natyrisht, sqarimi i kësaj dukurie kërkon hulumtime, që i kapërcejnë synimet e këtij artikulli. Prandaj le të kthehemi në temën tonë, për të diskutuar nëse banorët shqipfolës të Epirit kanë qenë të vendosur atje pas pushtimit osman, apo kanë qenë pasardhës të pandërprerë të të parëve të tyre vendës. Edhe për sqarimin e kësaj çështjeje, në mungesë dokumentesh historike, mund të mbështetemi vetëm në shqyrtimin e rrethanave historike-shoqërore, që mund të përligjnin njërën apo tjetrën zgjidhje. Po të kemi parasysht karakterin e shtetit feudal musliman turk, në asnjë mënyrë nuk mund të mendohet që pushtuesit turq të kenë mbështetur elementin shqiptar në dëm të elementit grek, sepse të dy palët në shekujt XV-XVI për turqit ishin “kaurë”. Dhe, së fundi, dy fjalë edhe për fshatrat greqishtfolëse të Dropullit e të Vurgut, ashtu si paraqiten në defterët e vjetër osmanë të regjistrimit të popullsisë. Edhe në këtë rast, për të mos u zgjatur pa nevojë, po kufizohemi në dokumentimin e emrave tipikë shqiptarë Lekë, Gjon e Gjin.

Sipas regjistrimit osman të vitit 1519-1520, në fshatin Goranxi e Sipërme (me 170 kryefamiljarë) trajta karakteristike shqiptare Gjon del 30 herë si emër vetjak apo si mbiemër (llagap): Gjon Sima, Gjon Braili, Gjon Petra, Gjon Martini (2 herë), Gjon Guma (2 herë), Gjon Tupe, Gjon Gjini (2 herë), Gjon Brati, Gjon Thanasi, Gjon Nika, Gjon Pali, Gjon Leka (2 herë), Dhima Gjoni, Leka Gjoni (2 herë), Deda Gjoni (2 herë), Kava Gjoni, Guma Gjoni, Sima Gjoni, Martin Gjoni, Zoja (Zota) Gjoni, Vreto Gjoni, Stamad Gjoni, Gjin Gjoni, Gjika⁴ Gjoni.

Po në atë fshat, del shpesh (24 herë) edhe emri tjetër tipik shqiptar Gjin: Gjin Leka (2 herë), Gjin Dedushi, Gjin Dhima (2 herë), Gjin Gjoni, Gjin Isheri, Gjin Muzhaqi, Gjin Martini, Gjin Deda, Gjin Boga, Gjin Kondi, Lush (Losh?) Gjini, Gjon Gjini

(2 herë), Leka Gjini (2 herë), Deda Gjini, Stoja Gjini, Nika Gjini, Andre Gjini, Dhima Gjini, Kond Gjini, Shtin Gjini. Do shënuar se ndër kryefamiljarët e atij fshati nuk del asnjë herë trajta Jani, e ndikuar nga greqishtja.

Po kështu, edhe në fshatin Goranxi e Poshtme (me 151 kryefamiljarë), në të njëjtin defter osman ndeshen emrat Gjon e Gjin, si p.sh.: Gjon Papadopulo, Gjon Bazhani, Gjon Deda, Gjon Kondi, Gjin Bazhani (2 herë), Gjin Ruvini, Gjin Kostandini, Gjin Nako, Gjin Andoni. Por këtu ndeshet më shumë trajta Jani.

Emrat Gjon e Gjin, si edhe emra të tjerë shqiptarë, janë të pranishëm në të njëjtin defter - diku më shumë e diku më pak - edhe në fshatrat e tjera të Dropullit, duke përfshirë edhe fshatin Derviçan afër Gjirokastrës, që në atë Defter paraqitet me një popullsi mjaft të madhe për kohën dhe që, me sa duket, ka qenë mjaft e ndikuar nga kultura greke. Kështu, edhe në atë fshat gjejmë emra karakteristikë të përdorur nga shqiptarët, si: Jani Gjini, Gjin Spato, Gjon Jorgji, Jorgo Gjoni, Nako Bard(h)i, Jorgo Babi, Mano Çuni, Dartho Çuni, Jani Çuni, Kosta Lula, Mano Shpata, Lluca Prushi, Dhimo Prushi, Jani Dragoi etj.⁵ Kurse në Sofratikë (me 61 kryefamiljarë) del vetëm një herë emri Gjin (Gjin Pavllo) dhe dy herë emri Gjon në fund të kryefamiljarëve: “Bashtina e vejushë Maries, e bija e Gjonit, në dorën e Gjonit.”⁶ Në këtë fshat ka edhe emra të tjerë shqiptarë, si: Niko Ballçi, Jorgo Ballçi, Dhimo Ballçi, Mano Ballçi, Vreto Leka, Niko Papileka, Staso Dimali. Ndër kryefamiljarët e atij fshati, mbizotërojnë emra prej burimi grek, si: Jani, Jorgo, Pavllo, Aleks etj. Por këta emra prej burimi grek, si ndër kryefamiljarët e këtij fshati, ashtu edhe ndër ata të fshatrave të tjerë të Dropullit, nuk janë shënuar me fundoren /-s/ karakteristike për emrat e greqishtes, si: Janis, Jorgos, Pavllos etj.

Prania e emrave tipikë shqiptarë në regjistrimet e para osmane në fshatrat e Dropullit dëshmon se ata banorë atje i kishin trashëguar këta emra brez pas brezi nga të parët e tyre. Mundësia që të parët e tyre të kenë shtegtuar atje dikur në të kaluarën dhe të kenë asimiluar një popullsi të mëparshme greqishtfolëse, përjashtohet për këto arsye: 1. Ndonjë shtegtim i tillë nuk dëshmohet historikisht, megjithëse, siç dihet, kronikanët grekë kanë qenë shumë të vëmendshëm për të shënuar lëvizje të tilla popullsish. 2. Një popullsi më pak e zhvilluar, siç kanë

qenë të parët e shqiptarëve, nuk mund të asimilonin një popullsi relativisht më të zhvilluar, siç kanë qenë grekët, aq më shumë kur këta kishin edhe mbështetjen e administratës bizantine dhe të Kishës Ortodokse Greke, që si gjuhë zyrtare kishin greqishten. Siç dihet, pas ndarjes së Perandorisë Romake në dy pjesë, Perandoria e Lindjes (a Bizantine) me kryeqendër Bizantin, si gjuhë zyrtare të administratës dhe të ushtrisë dalngadalë e zëvendësoi latinishten me greqishten dhe kjo e dyta, aty nga fundi i shekullit VI, mbeti e vetmja gjuhë zyrtare e asaj Perandorie dhe njëkohësisht edhe gjuha zyrtare e Kishës Otodokse.

E njëjtë paraqitet gjendja edhe për fshatrat sot greqishtfolës të Vurgut të Delvinës në kohën e pushtimit turk. Emrat e njerëzve me trajta tipike shqiptare ndeshen edhe në Defterin e Sanxhakut të Delvinës të vitit 1431-32 për Vurgun, që është quajtur kështu nga fjala e greqishtes së re vurkos “vend i ulët, moçalishtë”. Në atë defter atëherë janë dëshmuar vetëm katër fshatra: Finiki (Finiqi), Vurgo, Jeromi dhe Krajna (Kranéja) me shumë pak banorë⁷. Edhe në ato fshatra janë dëshmuar emra tipikë shqiptarë, si: Gjin Reçi, Gjin Panariti, Gjin Zagorino, Gjin Krali (Frali), Leka Gjini (2 herë), Kozha Gjini, Gjin Vija, Zhupa Gjin, Gjini Spiri, Gjin Andrea, Kont Gjin Andrea, Gjon Dorza, Gjon Zhurmo, Meksh Gjoni, Polimer Gjoni, por edhe Jani Jagop, Jani Katani, Jani Kosta, Jani Bogdani, Luka Jani, Jani Ispatari, Nika Jani (Finiq), Gjin Ilia, Gjin Pelegri, Gjin Kasnesi, Gjon Pelegri, Dhimo Gjini, Gjon Martini, Martin Gjoni, Deda Gjoni (Krane)⁸. Por, sipas Spiro Shkurtit⁹, në zonën e Vurgut më 1927 janë regjistruar 25 fshatra: Çukë, Pal, Aliko, Çaus, Tremul, Kasëmallajbej, Kaliveshush, Jermë, Halo, Kalivepasha, Krané, Ymerefend, Finiq, Vrion, Memushbej, Hajdëragas, Qenurjo, Karalibej, Vromero, Karahaxh, Mavropull, Metoq e Gjashtë,, Rahullë, Shijan, Muçopolit, Mullamus, që në vitin 1927 kishin një popullsi të përgjithshme prej 3262 banorësh. Pra, shumica e këtyre fshatrave duhet të jenë themeluar pas regjistrimit osman të shekullit XV. Madje, sipas Shkurtit¹⁰, disa nga fshatrat e reja të Fushës së Vurgut janë krijuar në fund të shekullit XVIII dhe në fillim të shekullit XIX. Një pjesë e mirë e banorëve të këtyre fshatrave të reja janë sjellë si bujq nga krahina greqishtfolëse prej Omer Pashë Vrionit, nga i cili ka marrë emrin edhe fshati Vrion¹¹, si edhe prej Ali Pashë Tepelenës. Por një

pjesë tjetër kanë ardhur ose janë sjellë me forcë edhe nga zona shqipfolëse. Për sjelljen me forcë të një pjese të kësaj popullsie në kohën e Ali Pashë Tepelenës, na dëshmon edhe ish-konsulli francez në Janinë, Pouqueville-i¹², i cili përshkruan një episod të tillë të vitit 1815: "... Ndërsa këta kolonë pleq linin pas varret e etërve të tyre, arrinin në këtë vend nga jugu i Epirit një pjesë e popullsisë së krishterë të Prevezës, grupe të tëra njerëzish nga Thesalia dhe Maqedonia, që i kishin zhvendosur si kope të ulëta, për të ripopulluar një vend, të cilin zemërimi i tiranit më hakmarrës po e shkatërronte ..."

Sipas Spiro Shkurtit¹³, një pjesë tjetër e popullsisë së fshatrave të Vurgut kanë ardhur aty nga vise shqipfolëse, kryesisht kodrinore e malore, në fillim si barinj me kopetë e tyre për kullota dimërore, por më pas janë vendosur atje për gjithmonë, ose për arsye të tjera. E një mendim të tillë e gjejmë edhe te Rami Memushaj, sipas të cilit shpërnguljet masive të popullsisë nga Kurveleshi "vijuan edhe gjatë shekullit XVIII nga shkaku i epidemisë së kolerës që preku më 1720 krahinën, por edhe për t'i shpëtuar trysnisë islamizuese, e cila në këtë shekull arriti kulmin e vet. Shumë familje u vendosën në fshatra të pellgut të Delvinës, të Bregdetit, të luginës së Drinos etj."¹⁴ Një dukuri e tillë nuk ka qenë e papritur, sepse gjatë shekujve, sidomos në disa periudha, kur mbipopullimi i viseve malore e ka bërë të pamundur jetesën në ato treva, një pjesë e popullsisë ka qenë e shtrënguar të shpërngulet dhe të vendoset në vise më të ulëta, sidomos kur këto kanë qenë më pak të populluara, siç kanë qenë viset e luginës së Dropullit dhe të Vurgut të Delvinës. Dhe me kalimin e kohës ardhacakët janë përzier edhe me anë martesash me banorët greqishtfolës, të sjellë, siç u përshkrua pak më sipër, me rrugë paqësore ose me forcë. Nga kjo përzierje ardhacakët e rinj të krishterë dalngadalë janë asimiluar gjuhësisht prej popullsisë së sjellë nga viset greqishtfolëse. Kjo dukuri, që do të meritonte të shqyrtohej më në thellësi, po të kishim dokumentimin e nevojshëm, nuk ka ndonjë gjë të papritur, po të kemi parasysh faktin e njohur që në viset kufitare me Greqinë greqishtja, duke pasur edhe mbështetjen e kishës ortodokse greke, me kalimin e kohës kurdoherë ka ngadhënjyer, aq më shumë kur pjesa greqishtfolëse ka qenë relativisht e madhe në numër, si në rastin

e fshatrave të Dropullit e të Vurgut. Për këtë dukuri mjafton të përmendim rastin e katundit më të madh të kësaj zone, Finiqin, i cili në kohën e regjistrimeve të para osmane paraqitet me një popullsi, që, siç u vu në dukje pak më sipër, mbartte emra tipikë shqiptarë, kurse sot paraqitet si greqishtfolëse. Ky fshat e ka ruajtur emrin e qytetit të lashtë epirot të Finikut (Phoenice), të themeluar jo më vonë se shekulli IV para erës sonë. Ndër gërmadhat e atij qyteti të lashtë janë zbuluar një teatër, akropoli etj., por nuk janë gjetur gjurmë varresh greke „brenda qytetit“.¹⁵

Por a ka qenë i vjetër elementi shqiptar në fshatrat e Dropullit dhe të Vurgut, apo shqiptarët a arbëreshët, siç quheshin më parë, atje kanë qenë të ardhur nga vise më veriore, sidomos gjatë shekullit XIV në kohën e Stefan Dushanit, për të cilin ndonjë studiues mendon se për zgjerimin e mbretërisë së tij e ka inkurajuar elementin shqiptar të zbrësë edhe në viset e të ashtuquajturit Epir, ku përfshihet edhe Lugina e Dropullit dhe Vurgu? Kështu, D. Nicol-i¹⁶ pohon se Stefan Dushani “inkurajoi shqiptarët që ta kryenin këtë punë për të duke u futur në Epir dhe Thesali”. Nuk del e qartë se për ç’dyndje shqiptarësh (a më saktë, arbëreshësh) në shekullin XIV është fjala në këtë rast. Në përgjithësi, dihet se në shekullin XIV, si edhe më herët e më vonë, kanë ndodhur shtegtime shqiptarësh në viset greke, sidomos në Thesali, Atikë, Beoti e Peloponez si edhe në disa ishuj grekë të Egjeut, si: Eubea, Hidra, Salamina etj. Arsyet e atyre shtegtimeve, që si të tilla dalin jashtë synimeve të këtij artikulli, janë trajtuar bindshëm në veprën e P. Xhufit, Dilema e Arbërit¹⁷, ku vihen në dukje edhe zonat greke, ku u vendosën shtegtarët arbëreshë dhe veprimtaria e tyre atje. Ajo që ka rëndësi të trajtohet në rastin tonë, është të sqarohet nëse viset e të ashtuquajturit Epir u populluan apo u çpopulluan nga arbërishtfolësit gjatë atyre shpërnguljeve të shekujve XIV-XV. Nga artikulli i porsacituar i D. Nicol-it të krijohet përshtypja sikur gjatë sundimit të Stefan Dushanit shqiptarët u inkurajuan të vendoseshin, ndër të tjera, edhe në Epir. Por ngjarjet historike të shekullit XIV, sikurse i ka sqaruar P. Xhufi¹⁸, dëshmojnë se Epiri dhe vise të tjera të Shqipërisë Jugore në vitet 20-30 të atij shekulli, si rrjedhim i kryengritjeve kundër pushtetit bizantin, u ballafaquan me një varg masash të rënda ndëshkimore, që shkaktuan, ndër të tjera, edhe emigrimin e masave të gjera të popullsisë shqipfolëse

drejt trevave greke. Për prejardhjen e masave shtegtuese të asaj periudhe nga viset e Shqipërisë së Poshtme, duke nënkuptuar në radhë të parë viset e të ashtuquajturit Epir, përveç të dhënave historike¹⁹, dëshmojnë edhe veçoritë gjuhësore të të folmeve të arbëreshëve të Greqisë, që janë shumë të ngjashme me të folmet jugore në përgjithësi dhe me nëndialektin e çamërishtes në veçanti. Mjafton të përmendim këtu faktin e njohur që, si në të folmet e arbëreshëve të Greqisë, ashtu edhe në çamërishte, ruhen ende grupet bashkëtingëllore /kl/ e /gl/ në fjalë të tilla si klumësht /= qumësht/, kleshë /= qeshë/, gluhë /= gjuhë/ etj., si edhe bashkëtingëllorja /-l-/ ndërzanore në fjalë, të tilla si: golë /= gojë/, bilë /= bijë/ etj. Dukuria e fundit dëshmohet edhe për të folmen e Gjirokastrës, ku trajtat arkaike golë, bilë etj. kanë qenë të zakonshme deri vonë.

Edhe nga sa u trajtua përmbledhtas në këtë artikull, besoj, del qartë vlera e madhe e defterëve osmanë, sidomos e atyre më të hershëm, për të hedhur më shumë dritë mbi disa probleme të vështira të historisë së popullit shqiptar dhe të gjuhës së tij gjatë periudhës së pushtimit osman të viseve të ndryshme shqipfolëse. E vlera e të dhënave të atyre të dhënave merr përmasa edhe më të mëdha, po të kihet parasysh se gjendja demografike e viseve shqipfolëse, e pasqyruar në defterët më të vjetër osmanë, është një tregues i qartë për gjendjen demografike të këtyre viseve edhe shumë shekuj para kohës, kur është bërë regjistrimi i popullsisë nga pushtuesit osmanë.

Shënime:

¹Shih Manolis A. Triandafilidhis: Gramatikë e vogël e greqishtes së re. Pëtkthyer nga Dhori Q. Qiriazhi. Selanik 1995, faqe 12.

²Shih E. Schwyzer: Griechische Grammatik . Auf der Grundlage von Karl Brugmanns Griechischer Grammatik. I, München 1959, faqe ; Helmut Rix: Historische Grammatik des Griechischen. Darmstadt 1976, faqe

³ Shih Selim Islami

⁴ Edhe Gji-kë < Gjin-kë është një emër tipik shqiptar, që ndeshet dendur në Shqipërinë e Jugut jo vetëm ndër të krishterët, por (si mbiemër) edhe ndër muslimanët.

⁵ Shih Duka, Ferit, vep. e përm. ff. 171vv.dhe 192vv.

⁶ Shih Duka, Ferit, po aty, f. 198v.

⁷ Shih Shkurti, Spiro: Vurgu. Vështrim etnografik. Tiranë 1987, faqe 24..

⁸ Shih po ai, po aty, faqe 27 – 29.

⁹ Shih po ai, po aty, faqe 46v.

¹⁰ Po ai, po aty, faqe 43.

¹¹ Po ai, po aty, faqe 35, 43.

¹² Shih. Pouqueville, F.C.H.L. Voyage de la Grèce, vol. II (deuxième édition. Paris 1926), faqe 27.

¹³ Vep. e përm., faqe 38vv.

¹⁴ Shih Memushaj, Rami. Histori e Kurveleshit, I. Tiranë 2004, faqe 36.

¹⁵ Shih më hollësisht për këtë qytet të lashtë të Epirit veprën e N.G.L. Hammond, Epirus, Oxford, 1967, faqe 112-117.

¹⁶ Nicol, D., The „Despotate of Epirus“. Në: Epirus: 4000 years of Greek history and civilizatzion. Athens 1997, faqe 211v.

¹⁷Tiranë Dilemat e Arbrit, Tiranë 2006, faqe 357 – 369.

¹⁸ Shih vep. e përm., faqe 358v – me dokumentimin përkatës).

¹⁹ Shih P.Xhufi, vep. e perm., faqe 314v.